



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:157945

Datë: 05.07.2024

Numri i dokumentit: 05987159

KPPP.nr.59/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Terminal” Sh.P.K. me NRB 70644231, me seli në Hani i Elezit, rr. “Dëshmorët e Krivenikut” p.n., të cilin me autorizim e përfaqëson Sabri Kryeziu avokat në Lipjan, kundër debitorit “Sharr-Cem” Sh.P.K., me NRB 70708396, me seli në Hani i Elezit, rr. “Adem Jashari” p.n., të cilin me autorizim e përfaqëson Dastid Pallaska, avokat në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.99/2015 të datës 26.03.2015 të Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli të zyrës në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, 18.06.2024 me datë 05.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Sharr-Cem” Sh.P.K., me NRB 70708396 dhe seli në Hani i Elezit, rr. “Adem Jashari” p.n., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.99/2015 i datës 26.03.2015, i Përmbartuesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Terminal” Sh.P.K. me seli në Hanin e Elezit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.99/2015 të datës 05.03.2015, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturë nr.185/N e datës 10.12.2014, të lëshuar nga kreditori. Me këtë urdhër është lejuar përmbartimi ndaj debitorit për pagesën e borxhit në shumë prej 121,920.00 €, me kamatë prej 8%, duke llogaritur prej datës së rënies në vonesë deri në pagesën definitive, si dhe me shpenzimet e përmbartimit sipas listës së

shpenzimeve. Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, debitori ka qëndruar plotësisht pranë prapësimin dhe ka përfshirë referencën e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të datës 07.12.2016, ku janë shpjeguar gjerësisht shkaqet e prapësimin. Debitori ka theksuar se kreditori nuk ka pasur autorizim ligjor për ofrimin e shërbimit që ka qenë objekt i faturës së parregullt. Kreditori, si terminal i autorizuar doganor, ka pasur të drejtë të ofronte shërbime terminale për vend parking deri në 24 orë për subjekte juridike që kryenin procedurat e zhdoganimit për një çmim prej 40 eurosh. Megjithatë, ai nuk ka pasur autorizim të faturonte 30 euro për secilin kamion që kalonte nëpër rrugën publike, që është vendkalim zyrtar i kufirit të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Kjo është arsyeja pse fatura e parregullt nuk ka përbërë dokument të besueshëm. Debitori ka shtuar se ai asnjëherë nuk e ka pranuar faturën e parregullt dhe ka kundërshtuar përpjekjet e kundërligjshme të kreditorit për të faturuar kalimin e kamionëve nëpër rrugën publike/vendkalimin ndërkombëtar. Ky fakt është vërtetuar me provën nr. 2, ku debitori ka adresuar shkresa zyrtare autoriteteve publike, përfshirë Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Ministrinë e Infrastrukturës. Ai ka theksuar se praktikën e kundërligjshme të kreditorit për faturimin e kalimit të kamionëve në rrugën zyrtare të vendkalimit kufitar kanë qenë objekt raportimesh mediale, të bashkangjitura si prova nr. 3. Këto raportime kanë përmbajtur deklaratatë të zyrtarëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Komunës së Hanit të Elezit, të cilët kanë konfirmuar se rruga publike mbi të cilën kreditori ka vendosur barrierën është pronë publike me destinim rrugë, mbi të cilën kreditori nuk ka pasur asnjë të drejtë. Data e këtyre raportimeve ka qenë e rëndësishme pasi vetëm pas ekspozimit të praktikave të kundërligjshme, kreditori i ka ndërprerë ato, për t'i rifilluar vetëm pas disa muajve. Debitori asnjëherë nuk ka pranuar asnjë shërbim nga kreditori dhe ka kundërshtuar përpjekjet e kreditorit për të përfituar kundërligjshëm. Kjo shpjegon pse fatura e parregullt nuk është pranuar dhe është kundërshtuar nga debitori, duke mos përmbushur elementet ligjore të detyrueshme sipas ligjit për TVSH të specifikuar në prapësim. Për këtë arsye, prapësimi duhet të aprovohet plotësisht. Lidhur me ekspertizën financiare të ekspertit V.I., debitori ka theksuar se e ka kundërshtuar me shkrim dhe ka qëndruar pranë këtij kundërshtimi. Tani që çështja është bartur në Gjykatën Komerciale, debitori ka kërkuar që gjykata të caktojë një ekspertizë të re me detyra të qarta sipas aktvendimit të Gjykatës Supreme. Ekspertiza e z. V.I. ka qenë e padobishme, pasi nuk ka treguar përmbajtjen e faturës së parregullt dhe ka përmendur dokumente që nuk kanë pasur autenticitet ose ndërlidhje me objektin e kësaj çështjeje përmbarimore. Dokumentet e përdorura nga z. V.I. kanë treguar shpërputhje thelbësore me faturën e parregullt.

Përfaqësuesi i kreditorit ka kundërshtuar prapësimin e debitorit. Gjatë seancës dëgjimore ka theksuar se ka pranuar ekspertizën financiare dhe kundërshtimin nga pala debitore. Për shkak të pamundësisë për t'i vlerësuar ato, ai nuk ka mundur të deklarohet lidhur me ekspertizën dhe kundërshtimin e saj në seancë, andaj nga gjykata është obliguar që kundërshtimin ta parashtrojë me shkrim. Në vazhdim, ai ka përsëritur qëndrimin e tij në përgjigje të prapësimit dhe deklaratat e dhëna në procedurën e shqyrtimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Dega Kaçanik, më 28.05.2015. Kreditori ka shtuar se në bazë të nenit 199 të LPK-së, udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës janë të obligueshme për gjykatën e shkallës së parë. Në faqet tre dhe katër të arsyetimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, qartësisht janë dhënë udhëzimet për veprimin në ri procedurë. Për këtë arsye, është punuar ekspertiza financiare, për të cilën kreditori është deklaruar në fillim të shqyrtimit të seancës. Në cilësinë e të autorizuarës të palës kreditore, kreditori ka përsëritur se kjo procedurë ka qenë e karakterit ekstra formal dhe ligjdhënësi ka përcaktuar kushtet mbi bazën e të cilave paraqitet prapësimi. Në rastin konkret, kontestohet dokumenti i besueshëm, fatura që ka qenë si titull përmbartimor, dhe hapet kontesti për të vlerësuar ligjshmërinë e faturës. Kjo nënkupton nëse fatura i përmban të gjitha elementet sipas ligjit për ATK dhe procedurat, pra a është përpiluar emri dhe mbiemri i përpiluesit të faturës, detyrimi, pala që i drejtohet, shuma e detyrimit dhe afati i përmbushjes. Kreditori ka argumentuar se fatura i përmban të gjitha këto elemente dhe pala debitore nuk ka paraqitur kundërshtim për rregullsinë e faturës. Pasi të përfundojnë këto afate, kreditori duhet të përmbushë detyrimet fiskale sipas kësaj fature. Ky ka qenë qëllimi i Gjykatës Supreme, të eliminohen këto elemente kontestuese me ekspertizë gjyqësore. Sa i përket pretendimeve të tjera, si njoftime mediatike dhe ndërprerja e faturimit për shkak të barrierës në dalje të vendkalimit kufitar, kreditori ka deklaruar se ka qenë i angazhuar dhe ka një vendim gjyqësor të plotfuqishëm. Kreditori nuk beson se pala debitore ka informacione të sakta dhe ka kundërshtuar që pala debitore të bie pre e spekulimeve mediatike, të cilat nuk kanë rëndësi në këtë çështje përmbartimore. Kreditori ka kundërshtuar propozimin për nxjerrjen e ekspertizës së re, duke e konsideruar atë jo parimore dhe në kundërshtim me nenin 359 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik lidhur me këtë çështje përmbartimore, me Aktvendimin PPP.nr.4/15 datë 17.06.2015, ka refuzuar prapësimin e debitorit, aktvendim që është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr. 2598/2015 të datës 08.09.2016. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimi EML.nr.1/2017, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, të njëjtën e ka pranuar si të bazuar dhe ka prishur Aktvendimin e Gjykatës

së Apelit dhe Gjykatës Themelore Ferizaj – Dega në Kaçanik, dhe e ka kthyer lëndën në shkallën e parë për rivendosje.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, me Aktvendimin PPP.nr.8/17 të datës 23.10.2018, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme, ka caktuar ekspertizë financiare, me detyrë që eksperti të vlerësojë të gjitha dokumentet financiare – dokumentet përcjellëse, dëftesat, faturat dhe evidencën tjetër që ka efekte financiare për çdo shërbim të kryer nga kreditori për debitorin prej datës 11.10.2013 deri më datë 31.12.2013 dhe prej datës 01.01.2014 deri më datë 16.10.2014.

Pas pranimit të ekspertizës, më datë 06.05.2021, përfaqësuesi i autorizuar i debitorit ka parashtruar kundërshtim ndaj të njejtës.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, lënda është transferuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik për në Gjykatën Komerciale të Kosovës për shqyrtim të mëtejme, në bazë të kompetencës lëndore, dhe ka marrë numrin KPPP.nr.59/22. Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore më datë 18.06.2024. Lidhur me ekspertizë, kreditori është deklaruar me shkrim lidhur me kundërshtimin e debitorit, dhe po ashtu edhe debitori ka parashtruar përgjigje në këtë kundërshtim.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklarimeve në seancë dhe atyre me shkrim të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerësoi se në rastin konkret dokumenti i besueshëm – fatura me nr.187/N e datës 10.12.2014, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e të

njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, sipas paragrafit 3, të nenit 29 të LPP-së, “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, ndërsa, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat, gjeti se dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura 187/N e datës 10.12.2014, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm. Kjo për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori.

Gjykata shqyrtoi edhe fletë kthesën e postës e cila është parashtruar nga kreditori si provë se fatura lëndore është pranuar nga debitori, mirëpo gjeti se e njëjta nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme pasi që tek emërtimi-lloji i dërgesës nuk është specifikuar lloji i dërgesës, vetëm “AR:”, dhe nuk ka të dhëna të tjera nga të cilat do të mund të konstatohej se fatura nr. 187/N ishte e dorëzuar në këtë zarf. Andaj këtë fletë kthim gjykata nuk e pranon si të rregullt me të cilin do të mund të vërtetohej se është pranuar fatura, për Gjykatën e njëjta paraqet pranim të dërgesës postare por jo edhe të faturës lëndore.

Gjykata shqyrtoi ekspertizën e punuar në këtë çështje, mirëpo gjeti se e njëjta nuk ka konstatuar pranimin e faturës. Konstatimet e tjera nga ekspertiza janë të panevojshme për gjykatën, meqenëse procedura përmbarimore, e cila i nënshtrohet parimit rigoroz formal, kufizohet vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi dhe ligjshmërisë së urdhrin përmbarimor. Gjykata vlerësoi dokumentin e besueshëm në rastin konkret si të parregullt dhe të pa përshtatshëm për përmbarim. Në këtë drejtim, propozimi për nxjerrjen e një ekspertize të re për gjykatën ishte i pabazuar, meqenëse gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit të besueshëm mbi bazën e elementeve që duhet të përmbajë, në mungesë të së cilave, edhe ekspertiza financiare nuk do të mund të konstatonte një gjendje tjetër nga ajo që ka konstatuar gjykata, andaj edhe të njëjtën e ka refuzuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05.L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04.L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08.L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.59/22 datë 05.07.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.